
POSTIM ARKIVOR

Arshi Pipa

(1920-1997)



SEKSIONI

Intelektualë, shkencëtarë

PERIUDHA

1947 - 1992

Arshi Pipa (28 korrik 1920 – 20 korrik 1997) ishte një ndër intelektualët më të shquar shqiptarë të shekullit XX, poet, filozof, kritik letrar, gjuhëtar, përkthyes dhe pedagog. I diplomuar në Universitetin e Firences për Letërsi dhe Filozofi, ai ushtroi profesionin e mësuesit deri në arrestimin nga regjimi komunist. Sipas dokumentacionit arkivor, u arrestua fillimisht më 27 prill 1946, ndërsa më 24 dhjetor 1946 u dënua me 20 vjet burg si pjesë e të ashtuquajturit grup social-demokrat, me akuzën për veprimtari kundër pushtetit komunist. Gjatë vuajtjes së dënimit në burgje dhe kampe pune shkroi fshehurazi ciklin poetik "Libri i Burgut" , një nga dëshmitë më të rëndësishme letrare mbi përvojën e burgut politik në Shqipëri. Pas lirimit në vitin 1956, u arratis një vit më vonë dhe u vendos fillimisht në Jugosllavi e më pas në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku zhvilloi një karrierë të shquar universitare dhe u bë një nga figurat më të rëndësishme të albanologjisë dhe të diasporës shqiptare. Pas vdekjes arkivi dhe biblioteka personale e Arshi Pipës iu dhurua Muzeut të Shkodrës. Është nderuar me titullin e lartë “Naim Frashëri i klasit të Parë” dhe "Qytetar nderi" i qytetit të Shkodrës.

EMIGRACIONI POLITIK | ARRATISJE | ALBANOLOGJIA | SHOQËRIA "VATRA" | STALINIZMI SHQIPTAR

PERMBAJTJE #1

Dokumentacioni për Arshi Pipën në arkivin e AIDSSH-së

Dokumentacioni arkivor për Arshi Pipën në fondet e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit pasqyron si ndjekjen e tij nga organet e Sigurimit, ashtu edhe interesimin e vazhdueshëm të regjimit për veprimtarinë e tij pas arratisjes nga Shqipëria. Ai përfshin dosjen hetimore-gjyqësore nr. 1167, me aktet e procesit penal ndaj Arshi Pipës dhe bashkëpandehurve, dosjen formulare nr. 273 (1960–1992), e cila dokumenton survejimin e tij dhe të familjes përmes raporteve, korrespondencës, fotografive dhe materialeve të tjera informative, si edhe dokumente të fondit të Komitetit Qendror të PPSH-së, ku pasqyrohen vlerësimet e regjimit mbi aktivitetin e tij akademik dhe intelektual në Perëndim, përfshirë pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare dhe analizat e tij mbi situatën politike në Shqipëri.

Fragment libri i propozuar nga familja Pipa dhe Kalakulla

Shkëputur nga libri në dorëshkrim “Kronikë familjare”, i Feime Pipës. Fragmenti është në proces botimi nga shtëpia botuese “Princ”. dhe publikohet me lejen e shtëpisë botuese. Arratisja e Arshi Pipës Feime Pipa Nji dit ë e takoi Arshiun nji shkodran me emnin Malo Kraja. Mbasi ia uroi lirimin tha se do të vinte në shtëpi për me pi kafen. Kur mbas dy ditësh ai erdhi e pyeti Arshiun troç: “A ke qef me ikë?” Mbasi Arshiu s’e njifte Malon e tue kujtue se ky mund te ishte provokim u përgjegj: “S’e kam mendue këtë punë”. “Mendoje” tha Maloja, “jam gati me të ndihmue”. Kur Sami Repishti, shok i Arshiut, dhe që kishte ba 10 vjet burg, erdhi te na, Arshiu e pyeti për Malo Krajën. Samiu tha se ai vinte nga nji familje shkodrane me traditë burrnje dhe se kishte qenë antar i Partisë së Legalitetit. Mbasi Maloja kishte nji hotel në Parrucë ku shkojshin me bujtë shumë lloj njerëzish, disa çuditeshin sesi regjimi e lejonte, tue dijtë të kaluemen e tij, me ba nji jetesë të privilegjueme. Disa të tjerë mendojshin se Maloja mund të ishte spiun i Sigurimit. “Propozimin me ikë ma ka ba edhe mue,” pat shtue Samiu. “A mund t’i besohet”? “Thom se po, tha Samiu, ai ka lidhje të ngushtë me nji katundar që ka qindrue në burg si burrë. Edhe ai asht i Legalitetit. Ka nji shtëpi në kufi me Jugosllavinë.” “Çka i shtyn ata me vue jetën në rrezik për ne”? “Janë njerëz të thjeshtë e ndoshta mendojnë se, po të ndryshojë situata, do ta kenë për mburrje me thanë se qenë ata që na shpëtuen jetën. Por ndoshta asht edhe nji gjest thjesht burrnije.” Malo Kraja erdhi te na disa herë natën. Kur Arshiu e përcillte, ata rrijshin deri vonë n’oborr tue bisedue për planin e ikjes. Këtë familja duhet ta merrte vesht mbasi t’ishte konkretizue. Plani u ba që Arshiu t’ikte me mue, Samiu me të motrën. Në gusht shkova në Durrës për me marrë prej nji studenti t’Arshiut, Zihni Dervishit, dy pushkë që do t’i përdorshim po të qe nevoja gjatë ikjes. Na nuk do të dorzoheshim gjallë po të diktoheshim. Dita e ikjes s’ishte caktue ende. Por plani ishte ky. Na do t’ikshim nji ditë pazari, në kohën kur katundarët kthehen te shtëpitë e tyne. Unë do të delsha veshë si katundare anamalse, me çarçaf e me ftyrë të zbulueme si t’isha grueja e Muhos. Nji katundar i ri do të më përcillte deri te ura e Bunës ku më pritëte Muhoja. Ky do t’ia diftonte letër njoftimin e grues së tij rojes që rrinte në krye të urës e mandej të tre do të vazhdojshim rrugën deri te vendi ku do të takoheshim me Arshiun. Për me u familjarizue me zakonet e grave anamalase, si edhe me shprehjen e ftyrës së tyne, shkova disa herë në Pazar. Ato vesheshin me çarçafë të vjetër, por pa arna, ma të mocmet mbajshin ballicë të bardhë nën pelerinën e carcafit. Dhe kur blesit afroheshin te dorcat e djathit të njomë e pa krypë që ato shitshin, anamalaset diftojshin shkurt çmimin e prodhimit të tyne e mandej vazhdojshin bisedën me njena tjetrën. Në përgjithsi ishin të pashpupurishuna e disi indiferente kur prodhimi s’u shitej. Dukeshin kondend me jetën: ajo e nji njeriu të thjeshtë që mbasi ka hangër nji copë bukë kallamoqe me nji krye qepe e tue pi hirrë në vend të tamblit, falnderon Zotin për at ushqim. Ikja u ba nji ditë në fund të shtatorit, kah ora katër mbasdite. Arshiu do të kalonte lumin me not sapo t’i jepej sheji me çakmak të ndezun prej anës tjetër të lumit, ku ai edhe unë do të bashkoheshim për me vazhdue ikjen. Arshiu më bani me krye kah rruga. Un kalova gardhin e hyna në rrugën e Tophanës. Kjo ishte shkret n’at kohë, me përjashtim të katundarit të ri që më pritëte. Un ktheva sytë kah Arshiu e kur ai më bani shej me ndjekë djalin, u vuna me ecë, ai para nja 20 hapa e un mbrapa. Te kroni i nji xhamije të vjetër u ndalëm, kinse me pi ujë. Aty i riu më tha se te ura e Bunës na priste dikush tjetër. Unë e dijsha se ai ishte Muho Seiti. Te kryet e urës nji katundar nja 40 vjeç iu afrue nji magjypi që shiste peshk, dhe si e kanë zakon katundarët kur kthehen prej pazarit, bleu prej tij nji vistër me saraga. Ai duhej t’ishte Muhoja. Roja, nji i ri me tipare katundari rrinte nja dy metra sipër urës afër parmakut të majtë. Dukej i ngeshëm, tue mos pasë njerëz për kontroll. Unë u shqetsova tue mendue se ai kishte kohë mjaft me kontrollue imtësisht letër –njoftimet, tue bazue fotografitë ndër to me ftyrat tona. Dhe mbasi unë s’përgjitsha asapk me fotografinë e letër-njoftimit të grues së Muhos, roja do të diktonte rrengun tonë. Plani ynë do të falimentonte! Në dorë kisha nji torbë me disa tesha t’Arshiut që ai do të veshte mbasi të delte prej ujit, diplomat tona shkollore dhe disa fotografi familjare. Në pambukun e shpatullave te xhaketës kisha qepë letrat e cigareve të “Librit të Burgut” t’Arshiut. Ato vjersha


kishin qenë arsyeja e qenjes së tij gjatë 10 viteve burg. Ishte i vetmi dokument që delte prej Shqipnisë tue i shpallë botës tmerret komuniste. Na kishim rrezikue jetën për me i nxjerrë ato prej burgut. E tash ato vjersha mund t'u bijshin në dorë komunistëve – jo nji e dy prej tyne, por toptan, krejt libri. Ai dokumentar do të zhdukej e bashkë me te edhe na! Isha në këto mendime që m'u përshkuen në tru njeni mbas tjetrit si vetima, tue ma mbajtë shpirtin të ngrimë, kur, si të kishin dalë prej tokës, nji grumbull katundarësh hypën n'urë dhe iu afruen rojes. Muho Seiti i ndoqi ata dhe mbas tij hypëm përcjellësi dhe unë. Mbështetun në parmakun e djathtë të urës dhe me shpinën kthye përgjysë kah roja, nxora prej strajcës nji copë bukë që fillova me e hangër për me dhanë përshtypjen se isha e unshme mbas pazarit. Njikohsisht mora qëndrimin indiferent të nji katundareje që prêt radhën me durim. Kur roja mbaroi së kontrolluemi letër –njoftimet e grupit të katundarëve dhe Muhoja po i afrohej rojes me letër –njoftimet tona, mue m'u dha me ulë dorën e djathtë me copën e bukës poshtë parmakut t'urës. Buka më përshqiti dore e ra n'ujë. Me te m'u duk se ra edhe dicka tjetër. Kur ngrejta dorën nalt, unaza e fejeses s'ishte ma në gisht. Tue e marrë këtë si nji ugur të keq, bërtita: "Unaza! Më ra unaza në Bunë! I shpejtë si zhiva, Muhoja u kthye kah unë dhe tue m'u drejtue si t'isha grueja e tij tha: "Mos hungro! të blej un nji unazë tjetër." Roja shikoi i habitun kah unë, ulun kryet si me turp, e u hodhi nji shikim të shpejtë letër njoftimeve. Mandej na bani shej me kalue tue u kthye kah nji grup tjetër katundarësh. Na shpejtuem hapat, por pa u dukë të ngutun, dhe kaluem urën e Bunës. Te fundi i urës morëm kah e majta në drejtim të fabrikës së çimentos. Ndërsa ecshim të tre në heshtje ndesheshim me grupe katundarësh që dojshin me bisedue me ne. Por Muhoja ua priste shkurt bisedën. Na shpejtojshim hapat për me i kalue ata, unë tue kthye kryet kah ana e kundërt e tyne. Dielli ishte ende i fortë sado që perëndimi i tij s'ishte larg. Me xhaketën nën çarçaf dhe tue ecë shpejt isha la në djersë. Muzgu i mbramjes ende nuk kishte ra kur tue dredhue kah e djathta mbërritëm te rranxa e nji kodre me disa banesa sipër. "Ky asht katundi Zus" tha përcjellsi im, dhe ktu asht shtëpija ime. Po ndalemi pak me pushue, ndërsa Muhoja po shkon me pritë tand vëlla te bregu i Bunës". Dhe më prini. Iu ngjitëm nji kodre nëpërmjet nji shtegu të ngushtë që na coi te nji oborr i vogël ku ishte shtëpija. Hypëm nja 10 kambë shkalle guri te nji derë e randë. Kur i riu e cili, u gjeta në nji odë të madhe pa njerëz. Aty heshtja ishte absolute. Dhe kur përcjellësi u largue mbasi mbylli derën, mendova se shtëpija ishte e pabanueshme. Kur ra terri fillova me u shqetsue për vonesën e Arshiut. Ikja e tij dukej ma e lehtë se e imja por në fakt rreziku ishte i madh. Plani ishte që Arshiu të përcillej prej nji shoku të Muhos te ura e Bahcallekut ku nuk kishte roje, dhe prej andej e tërthuer nji shtegu te nji vend me driza në bregun e Bunës. Por do të rrinte aty i mshehun deri të bahej natë, dhe mandej të kalonte Bunën me not, kur Muho Seiti t'i bante shej tue ndezë cakmakun. Aty Arshiu do të cvishej, do të futej në lumë tue synue bregun te vendi ku Muhoja kishte ndezë cakmakun. Jashtë ujit do të veshej me teshat e torbës e mandej të tre bashkë, por pa përcjellsin tim, që do të kishte kthye në shtëpi, na të tre do vazhdojshim udhëtimin e arratisjes. Simbas planit, kur shoku i Muhos, që quhej Mehmet Ademi, të kërciste dy herë te dera e oborrit të shtëpisë sonë, Arshiu do t'ishte gati me dalë, tue ndjekë Mehmetin në nji distancë 60 -70 metrash deri te ura e Bahcallekut e mandej tue u bashkue me te fill mbas kalimit t'urës. Rreziku ishte se Arshiu mund të binte në sy i veshun civil tue dalë jashtë qytetit. Mbasi lagjia e Bahcallekut banohej prej shum gjindsh, ndokush mund ta pikaste atë tue u futë në shtegun e mshehët. Isha në këto mendime kur befas ndigjova krisma pushke. Zemra filloi me më rrahë si me plasë dhe ndieva dhimë në gjoks a thue se nji danë po m'i shtrydhte mushknitë. Hova përjashta pa dijtë se ku me shkue e cka me ba. Mandej m'u kujtue se kisha lanë në dhomë xhaketën me vjershat e Arshiut. N'ankthin e tmerrshën se mos ishte vra im vëlla, së paku ato duhej të shpëtoheshin. Përcjellësi im, që kishte dalë edhe ai përjashta, tu e kuptue agoninë teme m'u afrue e më tha: "Pushkët qenë kah nji anë tjetër, diku larg". "E po të jetë ndryshe, çka bahem unë?" "Ti je e sigurtë këtu dhe të bajmë rrugë për Jugosllavi". Nji zhurmë kambësh erdh tue u afrue. Në dritën e hanës pashë siluetën e Arshiut që kullonte ujë. Me te ishte Muho Seiti. Arshiu u vesh e u mbath e un lashë çarçafin në dhomë. Diplomat e fotografitë i futa në gjoks. Duert duhej t'i kish të lira për me përdorë pushkën po të ishte nevoja. Përcjellsi im e kishte krye detyrën tue më prue deri të shtëpija e tij. Dhe ai angazhohej me më qitë në Jugosllavi po të kisha mbetë vetëm. Ai djalë i ri që sapo kishte fillue pranverën e jetës së tij kishte rrezikue jetën e vet për ne, pa

na pasë njoftë e pa shpërblim material. Unë e përqafova tue e falendërue. Ky ishte Jup Muharremi. Arshiu nuk kishte pasë trazim gjatë ikjes me përjashtim se, kur ishte hjedhë në not, i ishte dashtë me luftue më rrymën e ujit. Rruga e pazarit që ai e Mehmeti morën kishte qenë pothuejse shkret prej katundarësh e qytetarësh. Por, si mësuem ma vonë, nji bahcallekas, me emnin Dilaveri, kishte pa Arshiun e Mehmetin tue hy mes drizash për me u mshehë. Por kishte heshtë. Dhe Mehmet Adem kishte mbajtë fjalën me i dorzue Anesë teshat e Arshiut, si shej se kishte dalë Shkodrës gjallë. Shkodra e kishte ba burrnin e vet. Kur Muhoja, Arshiu e unë u nisëm në drejtim të Jugosllavisë, mund t'ishte ora 10 e natës. Terri s'ishte i thellë mbasi kishte hanë. Fatmirsisht ana e Taraboshit ku na udhtuen kishte pemë e kaçuba që lehtësojshin ikjen. Ana tjetër e malit, ajo mbi liqenin e Shkodrës ishte atëherë djerr, e lepuri mund të shifej tue nga. Me shkue prej Zusit në Muriqan, ku ishte kufini, s'merrte ma shumë se nja tri orë në kambë. Por ne na u desht me i ra Taraboshit tue ba zig-zage rrugë e pa rrugë, e tue i çilë vetes shteg mes drizash e ferrash. Taktika ishte me u ndejë larg katundeve. Njerzit flejshin n'at kohë. Por disa kryetarë këshilli katundesh që bashkpunojshin me sigurimin kishin qejf të stërvitun me ba roje. Na i ndigjojshim këta prej së largu tue lehë. Muhoja mbante në dorë nji copë mish për me ua hjedhë atyne po të na diktojshin. Në dorën tjetër ai mbante pushkën. Arshiu mbante nji tjetër. Kishte nisë me ague kur mbërrijtëm te vendi ku kaluem kufinin. Ishim jo ma shumë se treqind metra larg prej barakës së rojeve shqiptare. Ajo ishte njikatëshe, me nji oborr të vogël rrethue prej nji gardhi. Bamë këshillë me u hjedhë përtej apo me u mshehë në pyll e me pritë natën për me kalue kufinin. Rojet mund t'ishin ende tue fjetë. Por ndoshta edhe jo. Ndoshta ato po pregatiteshin me kontrollue zonën aty përreth. Mandej a nuk mund të nuhatëte erën tonë qeni që po lehte mbrendë në barakë? Vendimi u muer me dalë aty për aty. Muhoja i tha Arshiut: "Po të hapet dera qit! Mandej ai zhguli nji hu gardhi për me më ba mue shteg. Gardhi i vjetër bani krrap-krrap, unë e Muhoja dolëm të parët. Mbas nesh doli me pushkë në dorë Arshiu, tue shikue kah baraka. Kam përshtypjen se kaluem nji prrue të thatë e iu ngjitëm anës tjetër të bregut të tij. "Këtu jeni në tokë asnjanse" tha Muhoja. Baraka e rojeve jugosllave asht pak ma nalt në mal e do ta shifni. Ju priftë rruga e mbarë". Dhe kur Arshiu e pyeti nëse do të mshehej në pyll atë ditë tue pritë natën për me u kthye te shtëpija, ai tha: "Mos mbani kujdes për mue. Shtëpija ime s'asht larg prej këndej, vec nja 500 metra." Mandej u përqafuem. Ai u nis për Shqipni e na për Jugosllavi. Muho Seiti kishte qenë si herojt që losin me rreziqe të mëdha për me afirmue veten e tyne. Ai kishte nxjerrë në Jugosllavi para nesh dhe të tjerë. Mbas nesh ai nxori Sami Repishtin e ndoshta ndonji tjetër. Dikur ai u diktue dhe u vra në tokën e tij afër kufinit e mbasi i kishte ba rrugë shpëtimi dikujt. Muho Seiti, Malo Kraja, Mehmet Ademi e Jup Muharremi ishin zogistë. Qene zogistët ata që na shpëtuen jetën mue e Arshiut. Dhe për këtë u jam thellë mirnjohëse atynë si dhe organizatës së tyne.

MEDIA #1


Dosja dhe aktakuza

MEDIA FAQE #1



Dosja dhe aktakuza

MEDIA FAQE #2



Dosja dhe aktakuza

INFORMACION

Dosja dhe aktakuza

FONDI	Hetimor-gjyqësor
NR. I FLETEVE	78
LLOJI I DOKUMENTIT	Aktakuza (fleta që i përket Arshi Pipës)
DATA E KRIJIMIT	05.07.1947
STRUKTURA	Prokuroria Publike e Prefektures Durrës
VITI	1947
PROKURORI	Petrit Hakani
HAPËSIRA GJEOGRAFIKE	Durrës, Tiranë
	Arkivi i AIDSSH-së


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #2


Kërkesë për apel

MEDIA FAQE #1



Kërkesë për apel

MEDIA FAQE #2



INFORMACION

Kërkesë për apel

FONDI	Nr. 1, hetimor-gjyqësor
DOSJA	Nr. 1167
VITI	1947
HAPËSIRA GJEOGRAFIKE	Durrës


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #3

Udhëzime me tel

MEDIA FAQE #1



Me telin nr.480 date 16.5.1985 sh.Rasip Leli udhezon rezidenturat Nju Jork,Rome, Athine,Vjene :

Ka te dhena te konfirmuara se zbulimi amerikan dhe zbulime te tjera po tregohen shume aktive ne drejtim te qytetareve tane qe ndodhen per studime e specializim jashte.Ne kete drejtim jane aktivi zuar edhe kusdro shqiptare.Ne France,nepermjete nje pedagogeje nga Amerika, Arshi Pipa ka shperndare nje material armiqesor dhe ka qene disa here vet ketu per te takuar shtetas tane.

Prandaj,forconi punen per mbrojtjen e tyre,per perpunimin e Arshi Pipes dhe personave qe aktivizon zbulimi amerikan dhe te tjeret ne kete drejtim.Te punohet per te zbuluar ne kohe e parandaluar cdo veprim qe do te ndermeret.

U nxuar per zbulimin amerikan,anglez,gjerman, Arshi Pipen dhe mbrojtjen e qytetareve tane jashte nga p.op Idai Xhafa me 16.4.1985.

Udhëzime me tel

INFORMACION

Udhëzime me tel

FONDI	Drejtoria II
DOSJA	Nr. 237
TIPOLOGJIA E DOSJES	Formulare
LLOJI I DOKUMENTIT	Udhëzime me tel për rezidenturat
VITI	1985
GJUHA	Shqip
PUNETORI OPERATIV	Idai Xhafa
NR. I FLETEVE	1

BURIMI	Arkivi i AIDSSH-së


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #4

PARTY IDEOLOGY AND PURGES IN ALBANIA

MEDIA FAQE #1



TELOS 1984, NR. 59

3.4.85
205

PARTY IDEOLOGY AND PURGES IN ALBANIA

by Arshi Pipa

An aging Albanian Little Red Riding-Hood finds herself a lonely widow after having married and then divorced, one after another, the Yugoslax Wolf, the Soviet Bear and the Chinese Dragon. Each divorce entailed a thorough housecleaning, to make sure that the new partner, upon waking in the morning, would not risk stepping into the slippers of the preceding husband. Partial housecleanings have also occurred, involving removal of furniture and other belongings which, upon closer inspection, were identified as magic objects furtively introduced by the Western Ogre, lurking in the distance and waiting for his turn.

We can thus speak of purges related to four basic heresies: Titoism, Soviet social-imperialism, Maoism and Eurocommunism. The first three are explained as revisionistic variants of Marxism-Leninism in socialist countries mostly under the pressure of American imperialism. The same pressure on bourgeois European countries breeds Eurocommunism. Of the three revisionistic variants, Titoism stands in open collusion with capitalism, and therefore is the principal ideological enemy. And since Yugoslavia oppresses an Albanian population — in Kosova, Macedonia, Serbia and Montenegro — that amounts to more than two-thirds of the population in the mother country, Albanian Marxism-Leninism merges with Albanian nationalism to declare Yugoslavia Albania's archfiend.

After World War I, Albania was Yugoslavia's darling, the Communist Party of Albania (CPA) faithfully following the line of the Communist Party of Yugoslavia (CPY), its midwife and tutor. Had it not been for the break between the Soviet Union and Yugoslavia in 1948, Albania would be the seventh republic of Federal Yugoslavia today. Yet the bitter enmity between the two countries goes back to the Balkan Wars, when Albania frustrated Serbia's attempts to annex part of it by achieving independence (1912), and then to the 1912 London Conference of Ambassadors, subsequently confirmed by the 1913 Florence Protocol, which assigned royalist Yugoslavia a part of the defunct Ottoman Empire that was overwhelmingly populated by Albanians. Communist Yugoslavia accepted this inheritance, and then proceeded to incorporate the whole of Albania. The attempt failed because a nationalist faction in the CPA led by Enver Hoxha and Mehmet Shehu managed to defeat the Titoite faction thanks to Stalin's denunciation of the CPY as anti-Soviet.

The ensuing sweeping purge was approved by the nationalistic population who was also pleased to see the Party's name changed into that of the Party of

69

PARTY IDEOLOGY AND PURGES IN ALBANIA

INFORMACION

PARTY IDEOLOGY AND PURGES IN ALBANIA

Autoret: Arshi Pipa

FONDI	Drejtoria II
DOSJA	Nr. 237
	1960-1992
NUMRI I FAQEVE	403
TIPOLOGJIA E DOSJES	Formulare
HAPËSIRA GJEOGRAFIKE	SHBA
GJUHA	Anglisht
VITI	1984

BURIMI	Arkivi i AIDSSH-së


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #5

Letër anonime

MEDIA FAQE #1



Zotni Arshi Pipa

Keto dite na kane ra ne dore do shkrime e fjalime tujat mbi Kosoven e Shqipnine.Quditena si munet me i thane vedit shqiptar me tane keto peshtersina e shpifje qe bani.Per zotnine tuej Shqipnia na kanka e pushtume dhe e robnume nersa Kosova e kosovaret te lire,te lumtun e te gezum.Kosova per njat liri e barazi ashtu tue luftue e tue u gjakos,por per ty burgjet e mbushuna plot me te rije kosovare e vujtjet e shkaktume nga shovinizmi serbomadh na kankan jetese e gezume.Tash tane bota po e din se Shqipnia asht e lire dhe e pamvarun,nersa kosovaret shtypen e vujne,por zotnia juej si afije i Beligradit e anmiqve tjere te kombit shqiptar po e perlyni vedin perhere e ma shume ne pune te flliqta ne dam te Kosoves e Shqipnise.Tash po te njohim fort mire kush asht syrreti yt e keto skena me ti fal kurre.Do te baje mire me shiku punen tande e mos me e ça ma tej trathtine tande ndaj kombit shqiptar,aryshe do te dijme ne si me ta mshel gojen e si me te shperbly per poshtersinat qe ke ba e po ban.

Vdekje afijeve e trathtarve
Rrnofte Kosova e Shqipnia
Rrnofte kombi shqiptar

Letër anonime

INFORMACION

Letër anonime

FONDI	Drejtoria II
DOSJA	Nr. 273
TIPOLOGJIA E DOSJES	Formulare
	1957-1992
	403
GJUHA	Shqip
PUNETORI OPERATIV	Isai Xhafa
VITI	1986

	Arkivi i AIDSSH-së


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #6

Informacion

MEDIA FAQE #1



Me telin nr.2391 date 27.12.1988 sh.S[redacted] Q[redacted] njofton MPJ :

Prof.K[redacted],albanolog ne universitetin e Bonit,u be organizator per te ftuar Arshi Pipen ne nje konference ne institutin e gjuhesise.Arshi mbajti temen "Fenomeni Kadare".Shoket tane [redacted] dhe [redacted](jane per specializim ne Bon) e muaren vesh perpara dhe baze poresise tone,me kujdes i ngriten drejtorit te institutit prof.S[redacted] qe te evitonte konferencen ne fjale nisur nga fakti qe ne kete institucion studjonin dy perfaqsues te Akademise se Shkencave te RPSSH , se aktualisht dy vendet tona kane marredhenie diplomatike e marrevesh je kulturore dhe nuk ka perse te ftohen armiq te Shqiperise per te folur per te etj.. Megjithe kete nderhyrje,"albanologu" K[redacted] reali zoi konferencen ne fjale.

Meqenese isha i ftuar edhe une per nje vizite zyrtare ne kete institut,dhe meqenese,pak a shume korespondonte ne kohe me konference i dergova fjale drejtorit te institutit qe ambasadori nuk do te beje viziten,duke nxjerre nje shkak te rastit.

Duket se K[redacted] e ndonje albanolog tjeter vazhdojne te mbajne lidhje me armiq te vendit tone.Aktiv ne kete fushe mbetet edhe Martin Camaj,i cili deri pak kohe me pare ishte shef i katedres se shqipes ne Mynih.

Shenim: Teli eshte pare nga shoku Ramiz Alia, sh.Adil, sh.Foto e sh.Hekuran,pa shenime.

Puntori Operativ
Idai Xhafa

Informacion

INFORMACION

Informacion

FONDI	Drejtoria II
DOSJA	Nr. 273
TIPOLOGJIA E DOSJES	Formulare
	1957-1992
	403
GJUHA	Shqip
NUMRI I FAQEVE	1
PUNETORI OPERATIV	Idai Xhafa

BURIMI	Arkivi i AIDSSH-së


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #7

Faqja e dytë e informacionit nr. 124, datë 8.5.1989

MEDIA FAQE #1



2.

S q s r i m:

Dërguesi i letrës nuk njihet nga ana jonë.

Marrësi i letrës, B S , ka kunatë Arshi Fipen i arrestuar me aktivitet armiqësor kundër vendit tonë. Nisur nga kjo mendojmë se letrën e dërgon Arshiu ose pjesëtar i familjes së Arshiut paverësisht se maskohet me emrin T J ose Çesk siç e ka vënë në fund të letrës.

V l e r ë s i m:

Paverësisht se në pamje letra është familjare, nga përmbajtja të le të dyshosh për komunikim me parulla.

Masat operative:

Me informacionin të njihen drejtuesit e Drejtorisë I.

Letra para se të niset për në destinacion të kalojë në laborator për analizat fiziko-kimike për të parë se mos ka shkrim sekret.

Fotokopja e letrës t'i dërgohet DPB Durrës, e cila të verifikoj kush është marrësi e dërguesi? Kush janë personat që përmenden në letër, si D , D , M e S , për të cilët interesohet dërguesi? Të verifikohet në se është e:vërtetë që D ka qenë e shtruar në spital. Cilët janë kushërinjtë e marrësit e të dërguesit) për të cilët dërguesi pyet"ç'bëhet me kushërinjtë e tjerë?" etj

Informacioni t'i kalojë Degës I për evidencim e ndjekje, Drejtorisë III dhe një kopje të vendoset në dosjen e drejtimit.

Dega e V, sektori i K.P. të rrisë më tej kujdesin për kapjen e vlerësimin e kësaj korespodence, e cila zhvillohet me maskim.

E përpunoi p.op.

"Vera"

SHEFI I SEKSIONIT TË K.P.

GJERGJI THANO

Faqja e dytë e informacionit nr. 124, datë 8.5.1989

INFORMACION

Faqja e dytë e informacionit nr. 124, datë 8.5.1989

FONDI	Drejtoria II
DOSJA	Nr. 273
TIPOLOGJIA E DOSJES	Formulare
	403
GJUHA	Shqip
LLOJI I DOKUMENTIT	Sqarime
PUNONJËSI OPERATIV	"Vera"
STRUKTURA	Sektori i kontrollit postar

FIRMOSUR NGA	Gjergji Thano


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #8

Plan masash

MEDIA FAQE #1



MIRATOHET
ZV/DREJTORI I DREJTORISE III
/RAZIP LELI /

Sekret
Ekzemplar i vetem
Tirane,me 20.4.1985

PLANI I MASAVE
AGJENTURORO-OPERATIVE NE DREJTIM TE ARSHI PIPES

Per te zbuluar dhe parandaluar ne kohe veprimtarine armiqesore qe zhvillon Arshi Pipa kunder vendit tone ne favor te zbulimit amerikan dhe zbulimeve te tjera me te cilat bashkepunon,do te punohet per realizimin e ketyre detyreve:

1-Do te studjohen materjalet qe disponohen e behet nje permbledhje e hollesishme mbi veprimtarine armiqesore te tij kunder vendit tone,duke evidentuar edhe te gjitha lidhjet e tij jashte.(Prill I985)

2-Percaktohen burimet qe kane dhene e qe do te aktivizohen ne drejtim te A.Pipes si dhe detyrat konkrete te secilit.(Maj I985).

3-Studjohen e percaktohen kush nga lidhjet legale ne radhet e kolonise patriotike e kosovareve patriot ne SHBA mund e do te shfrytezohet ne drejtim te tij (Maj-dershor e ne vazhdim).

ne kuadrin legal


4-Udhezohen b.p qe do ta perpunojne per te mesuar mbi veprimtarine konkrete te A.Pipes kunder vendit tone,detyrat qe i jane caktuar nga zbulimi amerikan,kuadrot e zbulimeve te huaja me te cilet mban kontakte,lidhjet e karakteri i mardhenieve te tij me kuadro e pet goge te shkolles se zbulimit amerikan ne Monterei te Kalifornise etj.
E vazhdushme.

5-Do te ndiqet me precedence dhe zbulohet veprimtaria e A.Pipes ne drejtim te shtetasve tane me shdime ose specializim jashte, detyrat qe i jane caktuar nga zbulimi amerikan etj ne kete drejtim; karakteri i mardhenieve te tij me petagogen amerikan [redacted] ne Paris dhe detyrat qe i ka ngarkuar asaj ne drejtim te studenteve tane.
(Gjate vitit e ne vazhdim)

6-Thellohen e konkretizohen te dhenat per mardheniet e

Plan masash

MEDIA FAQE #2



-2-

bashkepunimin e tij me zbulime te tjera si si jugosllav,grek etj dhe detyrat qe i jane ngarkuar e kryen kunder nesh ne favor te tyre.
(I985-I986)

7-Do te ndiqet e zbulohet qellimi i vertete i levizjeve te shpeshta te A.Pipes e motres se tij ne shtete te ndryshme si Jugosllavi,France,Itali etj,detyrat qe kryen,kontaktet qe realizon, lidhjet e tij ne keto shtete etj.(E vazhdushme).

8-Veprimtaria qe zhvillon kunder nesh ne kuadrin e organizates "Vatra",lidhjet e mardheniet me kreret e saj,perpjekjet qe ben per te futur atje kosovare,udhezimet e detyrat qe ka nga zbulimi amerikan ne drejtim te "Vatres" etj.(E vazhdushme)

9-Aktiviteti qe zhvillon e detyrat qe i jane caktuar nga zbulimi amerikan ne kuadrin e "Shoqates per Studime Shqipetare", "Qendres Shqipetare",lidhjet me [redacted] e antare te tjere te ketyre shoqatave ne kuadrin e veprimtarise armiqesore kunder vendit tone (Gjate vitit I985-86 e ne vazhdim).

IO-Mardheniet e bashkepunimi i tij me organizma te tjera te zbulimit amerikan ne SHBA e gjetke si katedrat e gjuhes shqipe, qendrat "studimore-shkencore","albanologjike",me studjues te vendit tone,specialiste dhe ekzperte per vendin tone e Ballkanin etj.
E vazhdushme 85-86


11-Veprimtaria armiqesore qe zhvillon nepermjet shkrimeve e botimeve te tij;te sigurohen ato ne kohe e zbulohet qellimi i tyre e objektivat qe synon te arrije zbulimi amerikan e te tjere nepermjet tyre ne drejtim te vendit tone dhe masaes se shqipetareve jashte.
E vazhdushme.

12-Veprimtaria armiqesore qe A.Pipa zhvillon ne drejtim te Kosoves,kosovareve jashte,emigracionit ekonomik shqipetar,arbereshev ve ne Itali,qellimi i aktivizimit ne konferenca albanologjike,per ceshtje shqipetare,per Kosoven etj. (Gjate vitit I985 e ne vazhdim).

13-Per te realizuar sa siper do te aktivizohen me detyra konkrete burimet "5017","5027","5003","5010" si dhe burimet

Plan masash

MEDIA FAQE #3



236

-3-

"6402" " ", " 504 ",etj.,te cilet e njohin personalisht dhe kane dhene deri tani per te.(E vazhdueshme).

14- Do te behet nje leter operative udhezuese per rezidentu ren e Nju Jorkut lidhur me punen,detyrat e masat qe duhen marre per te zbuluar e parandaluar ne kohe veprimtarine armiqesore te A.Pipes kunder vendit tone.(Brenda muajit korrik I985)

15-Do te studjohet mundesia per pergatitjen e shperndarjen e nje materjali (leter) demaskuese per A.Pipen,si bashkepuntor i fashizmit e te huajeve ne pergjithesi kunder vendit e popullit te vet. (Deri ne gusht I985)

16-Do te evidentohen lidhjet shoqerorore e miqesore te tij ne vendbanim e ne shtete te tjera,duke mare edhe masat perkatese per perpunimin e tyre.(Gjate vitit e ne vazhdim).

I7_Do te ndiqet korespondenca e Arshi dhe Feime Pipes me lidhjet e tyre ne vendin tone dhe evidentohen reagimet e tyre.Do te studjohet mundesia e influencimit te tyre ndaj A.Pipes per ta larguar nga veprimtaria armiqesore kunder vendit tone.(Gjate vitit e ne vazhdim).

18-Cdo 6 muaj analizohet realizimi i detyrave ne drejtim te objektit ne fjale e percaktohen detyra per ndjekje te metejeshme.

19-Ne prill I987 behet analiza perfundimtare e planit te masave agjenturoro-operative ne drejtim te Arshi Pipes dhe behet plani i ri i masave.

Puntori Operativ
Idai Xhafa

D A K O R T
KRYETARI I DEGES V
SOKRAT ÇOMO

Plan masash

INFORMACION

Plan masash

FONDI	Drejtoria II
DOSJA	Nr. 273
TIPOLOGJIA E DOSJES	Formulare
LLOJI I DOKUMENTIT	Plan masash operative
NR. I FLETEVE	3
LLOJI I DOKUMENTIT	Plan i masave operative
VITI	1985
PUNETORI OPERATIV	Idai Xhafa
BURIMI	Arkivi i AIDSSH-së


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #9

Arshi Pipa (majtas) me Martin Camajn, Lengries, Gjermani. 1977. Fotografi e ofruar nga koleksioni i familjes Pipa dhe Kalakulla

MEDIA FAQE #1



Arshi Pipa (majtas) me Martin Camajn, Lengries, Gjermani. 1977. Fotografi e ofruar nga koleksioni i familjes Pipa dhe Kalakulla

INFORMACION

Arshi Pipa (majtas) me Martin Camajn, Lengries, Gjermani. 1977. Fotografi e ofruar nga koleksioni i familjes Pipa dhe Kalakulla

VITI	1977
VENDI	Lengries, Gjermani


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #10

Arshi Pipa, Little Rock, SHBA, 1960. Fotografi nga koleksioni i familjes Pipa dhe Kalakulla

MEDIA FAQE #1



Arshi Pipa, Little Rock, SHBA, 1960. Fotografi nga koleksioni i familjes Pipa dhe Kalakulla

INFORMACION

Arshi Pipa, Little Rock, SHBA, 1960. Fotografi nga koleksioni i familjes Pipa dhe Kalakulla

VITI	1960
HAPËSIRA GJEOGRAFIKE	SHBA

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #11

Arshi Pipa (djathtas) me Prof. Nicolas Chako, SHBA, 1961. Fotografi nga koleksioni i familjes Pipa dhe Kalakulla.

MEDIA FAQE #1



Arshi Pipa (djathtas) me Prof. Nicolas Chako, SHBA, 1961. Fotografi nga koleksioni i familjes Pipa dhe Kalakulla.

INFORMACION

Arshi Pipa (djathtas) me Prof. Nicolas Chako, SHBA, 1961. Fotografi nga koleksioni i familjes Pipa dhe Kalakulla.

VITI	1961
VENDI	SHBA

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #12

Arshi Pipa me një grup miqsh dhe familjarësh. Shkodër, korrik 1992. Fotografi nga koleksioni i familjes Pipa

MEDIA FAQE #1



Arshi Pipa me një grup miqsh dhe familjarësh. Shkodër, korrik 1992. Fotografi nga koleksioni i familjes Pipa

INFORMACION

Arshi Pipa me një grup miqsh dhe familjarësh. Shkodër, korrik 1992. Fotografi nga koleksioni i familjes Pipa

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.